



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Prot. 4546

Elbasan, 24.9/2021

NJOFTIM PUBLIK

Për shpallje konkursi

Me qëllim përjetësimin e figurave historike të qytetit të Elbasanit, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, VKM 510 datë 18.07.2012 “Për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor”, udhëzimit nr.1, datë 8.08.2012 “Për procedurat që ndiqen për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor, kriteret e vlerësimit dhe dokumentacioni ligjor”, Bashkia Elbasan shpall:

- Konkurs kombëtar për realizimin e bustit të heroit të popullit Qemal Stafa.
- Projekt-ideja, boceti, duhet të paraqiten pranë Bashkisë Elbasan, jo më vonë se data 25.10.2021 (afati duhet konsultur me specialist)
- Projektet dhe bocetet e paraqitura do të vlerësohen nga një juri e posacme, e cila do të përzgjedhë bocetin fitues. Bocetet e tjera do t'u kthehen autorëve të tyre.
- Shqyrtimi dhe vlerësimi i boceteve nga juria do të bëhet brenda datës 29/10/2021, në ambientet e Bashkisë Elbasan
- Pjesëmarrësit, duket të paraqesin një CV profesionale të tyre, dhe dokumentacionin përkatës për kualifikimin e tyre
- Ftohen artistë të artit figurativ, (piktorë , skulptorë) të marrin pjesë dhe të paraqesin project-idetë dhe bocetet e tyre
- Dokumentacionin teknik dhe ligjor me kerkesat për realizimin e kësaj vepre mund ti gjeni dhe tërhiqni pranë Bashkisë, drejtoria e Kulturës cdo ditë nga ora 8.00 deri 16.00.



KRYETARI
Gledian LLATJA